

Raporti narrativ 2015

- **“Darka e Lamës”**

19 dhjetor, e Shtunë, ora 20:00 – 23:30 “Darka e Lamës” në Qendrën Multimedia.

Ngjarje e përvitshme e Qendrës Multimedia, të cilën pak me humor e pak me përnjëmend e kemi quajur “Darka e Lamës” (nuk është kjo darka që e organizon Presidentja).

Programi i darkës ka përfshirë:

20:00 – 20:30 - Promovimin e librit të Shpetim Selmanit “Shënimet e një Grindaveci”.

20:30 – 21:00 – Lexim nga shkrimet e Shpetim Selmanit

21:00 – 22:00 - Zbavitje me raki, meze e muzikë

- **Publikimet e reja**

Qendra Multimedia ka publikuar tash së voni librin me poezi të autorit të mirënjohur slloven Jurij Hudolin, me titull “Revolucionarët e rinjë”. Librin në shqip e ka përkthyer mjeshtrisht Fadil Bajraj.

Jurij Hudolin (1973) është poet, shkrimtar dhe përkthyes slloven. Ka botuar një numër të përmbledhjeve me poezi dhe disa romane. Është i njohur për gjuhën e pasur që përdor dhe për qëndrimin e tij rebel dhe refuzues ndaj botës.

Është botuar edhe libri me poezi të Ervina Halilit, libri I Ballsor Hoxhës “Bardhëzi” dhe “Theks” e Alban Fejzës.

- **German Movie Nights at Qendra Multimedia**

Crossing the Bridge – Sound of Istanbul

Hannah Arendt

Këtë vit kemi shfaqur 2 filma gjerman me përkthim në gjuhën angleze në bashkëpunim me Goethe Institute.

- **Prezentimi i librit të Zijah A Sokoloviqit, "Aktori... është aktori...është aktor"**

Qendra Multimedia, në bashkëpunim me Regional Cooperation Council - RCC, ka promovuar librin "Aktori... është aktor...është aktor" të aktorit e autorit të mirënjohur nga Bosna e Hercegovina, Zijah A Sokoloviq.

Promovimi është mbajtur të Marten, me datë 1 dhjetor, nga ora 20:00 në Qendrën Multimedia.

Prezent ka qenë edhe aktori Sokoloviq, me të cilin kemi diksutuar për librin dhe për përvojën e tij si aktor.

Sokoloviq ka qenë aktiv nepër gjithë Ballkanin Perëndimor, si dhe në Austri. Ai është drejtor i "Theaterland" në Salzburg dhe ligjerues në Konservatorin "Bruckner" në Linz. Ai është përfshirë në filma, programe televizive dhe shfaqje të shumëta, por më së miri njihet për dy performancat e tij individuale "Aktori... është aktori... është aktor" dhe "Kabares kabarei". Aktivitetet e Këshillit Rajonal për Kooperim (Regional Cooperation Council - RCC) janë të fokusuar në promovimin dhe shtimin e kooperimit rajonal në Evropën Juglindore dhe në përkrahjen e integriteteve Evropiane dhe Euro-Atlantike për vendet që presin anëtarësim. Fokusi kryesor i aktiviteteve të RCCs shtrihet në fushat e zhvillimit ekonomik dhe shoqërorë; në energji dhe infrastrukturë; në drejtësi dhe çështjet e brendshme; në kooperimin për çështjet e sigurisë; në ndërtimin e kapitalit njerëzorë; në kooperimin parlamentar, aktivitetet e shoqërisë civile, etj. Por, një nga elementet kryesore të aktiviteteve për të ngritur prosperitetin ekonomik fokusohet në kooperimin rajonal në art dhe kulturë.

- **Literatura kosovare në Gjermani**

Qendra Multimedia ka organizuar një diskutim me përkthyesen nga Gjermania, Zuzana Finger. Gjatë prezantimit të saj ajo na ka treguar më shumë rreth përvojës së saj si përkthyes dhe literaturës kosovare e përkthyer dhe e publikuar në Gjermani.

Data: 25th of November

ora: 17h

vendi: Qendra Multimedia

- **Përkthyesi transparent**

Qendra Multimedia dhe TRADUKI kanë organizuar ngjarjen:

Përkthyesi transparent

Me datë 30 shtator, nga ora 18:00, në Qendrën Multimedia, është shënuar Dita botërore e Përkthyesve, e njohur edhe si Dita e Hieronymus-it.

Përkthyesi i njohur Shkëlzen Maliqi ka qenë pjesë e këtij shënimi, përmes punëtorisë "Përkthyesi transparent". Moderator i mbrëmjes ka qenë përkthyesi dhe studiuesi i letërsisë Anton Berishaj.

Cka është përkthyesi transparent?

Përkthyesi transparent e lejon publikun të shoh përtej 'krahëve' të tij/saj. Përkthyesi I bënë mendimet e tija gjatë përkthimit transarente, kurse vendimet për zgjedhjet të

debatueshme. Audiencia e sheh tekstin original dhe poashtu krejt cka ndodhë në ekranin e kompjuterit të përkthyesit: cka është duke shkruar, cka kërkon në ‘google’, si e përdorë fjalorin, enciklopedinë etj.

Përkthyesi i shfaqë poashtu teknikat e tija: nëse ka disa sinonime të mundshme, a l shkruan ai të gjitha dhe pastaj vendosë më vonë se cilën fjalë ta përdorë? A vendosë pikëpyetje në ndonjë pjesë, a le dicka të papërkthyer për më vonë? Etj.

Përkthyesi gjithashtu komenton se cka është duke bërë dhe me cilat problem është duke u ballafaquar.

Publiku mund të bëj pyetje, të jap sygjerrime ose t’l refuzoj disa zgjidhje të përkthyesit. Në këtë mënyrë, një public jo-ekspert, që nuk mendon për përkthimin cdo ditë, e bënë ngjarjen më të gjallë dhe më argëtuese.

Kjo ngjarje organizohet nga Qendra Multimedia dhe TRADUKI.

- **ENCIKLOPEDIA E TË GJALLËVE**

Një intervenim artistik në realitetet kosovare e serbe

Me datë 17 nëntor, 20:00 h, në Teatrin Kombëtar të Kosovës

Bashkëprodhim i Qendra Multimedia (Prishtinë) dhe Qendrës për Dekontaminim Kulturor (Beograd)

“Enciklopedia e të gjallëve” është leksikon teatror serbo-shqiptar, kosovaro-serb. Në te gjërat dhe personat emërohen ashtu siç janë. Porosia bazë e saj është se elita nacionale, nacionaliste, ia shpërndanë të varfërve hashashin e nacionalizmit në mënyrë që varfanjakët serbë e shqiptarë të shfarosen mes veti, ndërkohë që kjo elitë në të dy anët, nga kjo shfarosje e të mjeruarëve, të nxjerr profit dhe të forcoj pushtetin e saj. Mantrat kombëtare shërbejnë për të fshehur thelbin e shtesimit brendakombëtar klasor dhe për të zhvleftësuar esencën e vetive personale të çdo njeriu.

- **Teatri për fëmijë dhe të rinj në Gjermani**

Qendra Multimedia ka pas një diskutim mbi Teatrin për fëmijë dhe të rinj në Gjermani; si funksionon, kush e financon, si është e organizuar, si është i definuar repertori etj.

Panelistët kanë qenë dramaturgu Stefan Schletter dhe pedagogja e teatrit Katrin Singer nga Teatri për të rinj në Heilbronn.

Diskutimi është zhvilluar me datën 25 qershor nga ora 12:00, në Qendrën Multimedia. Ky diskutim ka qenë pjesë e një projekti më të madh të Qendrës Multimedia dhe Teatrit të të rinjëve në Heilbronn në Gjermani, i mbështetur nga Goethe Institute.

- **“Romeo and Juliet” play**

Premiera e shfaqjes Kosovaro – Serbe “Romeo and Juliet”, nga E. Shakespeare, regjia nga Predrag Miki Manojlovic, prodhuar nga Qendra Multimedia (Prishtina) dhe Radionica Integracija (Belgrade) 15 maj 2015 në Teatrin Kombëtar.

Performancat tjera kanë qenë me 16 maj (nga 17:00 h dhe nga 21:00) dhe me 17 maj, nga 20:00 h. Premiera ka qenë vetëm me ftesa.

Ky produksion është mbështetur nga Qeveria e Kosovës dhe Serbisë.

- **POLIP 2015 - LET’S TALK ABOUT FREEDOM!**

22 - 24 May 2015

Literatura pas -Charlie Hebdo-së

Mysafirë kanë qenë gjithsej diku rreth 30 autorë nga Ballkani dhe Evropa.

- **Lufta në kohën e dashurisë**

Produkti më i ri i Qendrës Multimedia “Lufta në Kohën e Dashurisë” ka pas premierën me 5 maj 2015 në orën 20h në Teatrin Kombëtar. Performance e radhës ka qenë me 6 maj 2015.

- **One Flew Over the Kosovo Theater është rishfaqur në prill 2015**

“One Flew Over the Kosovo Theater” është shfaqur me 17 prill 2015 në Teatrin Kombëtar. “One Flew Over the Kosovo Theater” është një komedi politike rreth pavarësisë së Kosovës.

- **SKA PROBLEM KEIN PROBLEM**

Ka pas thirrje për aplikim për projektin kosovaro-zviceran “KEIN PROBLEM S’KA PROBLEM”, për të rinjë të moshës 16 – 21

Qendra Multimedia nga Prishtina (Kosovë), në bashkëpunim me Schlachthaus Theater nga Berni (Zvicër) kanë duke realizuar projektin teatror “Kein Problem S’ka Problem” me të rinjë të moshës 16 deri 21 vjet.

Projekti është realizuar në Prishtinë (4- 8 tetor 2015) dhe në Bern (9 – 25 Prill 2016).

- **"Yue Madeleine Yue" është rishfaqur në Mars 2015**

"Yue Madeleine Yue" është rishfaqur në Mars, në 3 qytete të Kosovës, Pejë, Ferizaj dhe Gjilan. ata që nuk e kanë parë, kanë pas mundësinë ta shohin:

Me 3 mars ne Peje ne oren 19:00h

Me 4 mars ne Ferizaj ne oren 19:00h

Me 5 mars ne Gjilan ne oren 19:00h

PER SHFAQJEN

Në fokusin qendror të kësaj tragjikomedie është një familje rome, e cila është dëbuar me forcë nga Gjermania për në Kosovë. Të gjetur në një realitet të ri, kjo familje do të duhet të përballojë sfidat e shtetit të sapo formuar. Një vajzë rome, Madeleine, një ditë bie në një vrimë të hapur nga një kompani ndërtimi. Përderisa vajza në komë, lufton për jetën e saj, babai i saj, duke luftuar për drejtësinë përball me oficerë burokratik, biznismena, policinë, dhe puntorë të ambasadave. Kjo është një dramë politike për gjendjen kaotike të pasluftës në Kosovë por para se gjithash është një dramë për romët e pa dëshiruar në Evropë. Larg nga stereotipet e zakonshme për romët, „Yue Madeleine Yue“ është një dramë inteligjente që shqyrton në mënyrë të shkëlqyeshme procesin emocional që mijëra romë në Evropë e pësojnë, kapitulimin e proceseve të dhunshme të riatdhesimit.

- **PRISHTINA HAS NO RIVER – REZIDENCA LETRARE 2015**

Zuzana Finger – GJERMANI

Petar Andonovski – MAQEDONI

Lejla Kalamujic – BOSNJA&HERCEGOVINE

Vasko Raicevic – MALI I ZI